



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2020:125915

Datë: 06.07.2021

Numri i dokumentit: 01964013

**C.nr.1019/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si kontestimore i përberë nga Gjyqtari Individual Skender Shala, me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të paditësit V.I nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Valon Mehmeti nga Mitrovica, kundër të paditurës K...-Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati publik komunal Avdi Muzliukaj, për shkak të kompensimit të pagës jubilarë, pas mbajtjes së seancës kryesore publike të datës 01.07.2021, me datë 06.07.2021, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit V.I nga Mitrovica dhe,
- II. OBLIGOHET** e paditura K...-Mitrovicë, t'ia paguajë paditësit Veton Ibrahim, në emër të pagesës për shpërblim jubilar të e paditura, për më shumë se 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 1 page bazë, shumë prej 580.59 €, (Pesëqind e tetëdhjetë euro e pesëdhjetë e nëntë cent), në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.
- III. OBLIGOHET** e paditura K...-Mitrovicë, t'ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për përfaqësim në seancë shumë prej 135 €, dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20 €, pra gjithsejtë shumë prej 259 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

**A r s y e t i m**

Paditësi me datën 02.10.2020, ka ushtruar padi për kompensimin e pagës jubilarë, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, prej momentit të ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive, kjo duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale.

Gjykata, me datë 01.07.2021, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit, dhe përfaqësuesi i të paditurës. Paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbës në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë ashtu që e paditura për përvojën e punës të paditësit të e paditura mbi 10 vite, kërkon pagimin e

një page në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 580.59 euro. I propozon gjykatës që këtë kërkesëpadi pas administrimit të provave t'a vlerësoj si të bazuar, njëherit heqë dorë nga kamata. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë si në vijim, për përpilim të padisë shumë prej 104 €, për përfaqësim në këtë seancë 135 €, dhe në emër të taksës shumë prej 20 €.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë për arsye të mungesës së mjeteve bugetore për pagimin e pagës të cilën e kërkon paditësi, nuk e kundërshton nxjerrjen e provave. Nuk është kontestuese se paditësi ka punuar tek e paditura dhe është ende duke punuar, nuk është kontestuese as lartësia e pagës së paditësit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kontrata e punës në emër të paditësit e lidhur me të paditurën e datës 01.07.2020, kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës për pagimin e pagës jubilarë e datës 08.09.2020, vërtetimi për përvojën e punës në emër të paditësit, lëshuar nga e paditura me datë 19.08.2020, lista e pagës në emër të paditësit lëshuar nga BRK, pas shqyrtimit të këtyre provave, bashkërisht dhe secilës veç e veç, me kujdes dhe ndërgjegje, gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësi para ngritjes së padisë ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë të datës 08.09.2020 për kompensimin e pagës jubilarë, ku të njëjtën e ka pranuar e paditura po me të njëjtën datë, mirëpo në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi që e paditura ka kthyer përgjigje.

Nuk është kontestues fakti që paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura nga data 01.01.2005 e tutje, ky fakt vërtetohet nga Vërtetimi me numër të protokollit 670 i datës 19.08.2020.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 580.59 €, ku kjo vërtetohet nga pasqyra e qarkullimit të llogarisë bankare lëshuar nga RBK.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të të paditurës duke e kontestuar padinë si pasojë e mungesës së mjeteve buxhetore, pretendimet e lartëcekura gjykata i refuzoj si të pabazuara, dhe atë duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të miratuar me datë 11.06.2018, andaj për vendosje sipas pikës II të dispozitivit sa i përket pagesës së një pagave në emër të shpërblimit jubilar iu referua nenit 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të kontratës së lartcekur me të cilën parashihet se "Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një pagave mujore të tij", e në rastin konkret paditësi ka qenë i punësuar te e paditura për më shumë se 10 vite.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1. të Kontratës Kolektive Sektoriale është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurit që ti paguaj kompensimin për kategorinë e lartcekur.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për një

seancë të mbajtur në shumën prej 135 euro, 104 euro ne emër të përpilimit të padisë dhe 20 euro në emër të taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.1019/2020, datë 06.07.2021**

**GJYQTARI**  
Skender Shala

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtine. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.